# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6046
E enjte, 25 qershor 2020
çmimi 0.40 €


## BDI-ja prezanton Naser Ziberin kandidat për kryeministër të Maqedonisë së Veriut

FAQE 2





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR KA DËRGUAR NË DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS, ME SELI NË HAGË, AKTAKUZË PËR PRESIDENTIN HASHIM THAÇI DHE PËR KRYETARIN E PDK-SË, KADRI VESELI

# FILLIM I RI ME AKTAKUZA TË VJETRA POLITIKE





Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës aktakuzë për presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, dhe për kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli. Në njoftimin për media të ZPS-së është thënë se Thaçi, Veseli dhe të tjerët (nuk përmenden emra) akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte. Sipas aktakuzës, e cila ende nuk është konfirmuar, të dyshuarit janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje. Avokati Tomë Gashi ka vlerësuar se Gjykata Speciale e ka bërë publike këtë aktakuzë në kundërshtim me rregullat e saj ligjore pasi, sipas tij, është dashur të konfirmohet nga gjyqtari i procedurës paraprake. Presidenti Thaçi e ka anuluar pjesëmarrjen në takimin me Serbinë në Uashington pas ngritjes së aktakuzës nga Specialja. Ndaj kësaj aktakuze ka pasur reagime të shumta nga përfaqësues të politikës, të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe nga shoqëria civile

## OPINION

### MARRËVESHJA MADHËSHTORE NATO-RFJ 1999 DHE TERRITORI I KOSOVËS

F. 10-11

Prof. Dr. Murat MEHA



## AKTUALE

### LANSOHET APLIKACIONI 'LAJMËRO POLICINË'

F. 7

### OSMANI: POPULLIT TË KOSOVËS DUHET T'I JEPET LIBERALIZIMI I VIZAVE

F. 3

### 85 PACIENTË TË SHTRIRË NË KLINIKËN INFEKTIVE ME COVID-19

F. 8

### VELIU: QYTETARËT TË QËNDROJNË SA MË LARG ARMËVE ILEGALE DHE DHUNËS

F. 7

## EKONOMI

### "HUMANITY FIRST" DHURON MATERIALE MBROJTËSE PËR SINDIKATËN E PAVARUR TË DOGANËS

F. 9

### KRASNIQI: PRIORITETI IM, MBËSHTETJA E PRODHUESVE VENDORË

F. 9

## SPORT

### FERONIKELI KËRKON MAKSIMUMIN NDAJ DRENICËS

F. 6




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Shkon në 47 numri i të vdekurve në Shqipëri nga Covid-19

Tiranë, 24 qershor - Një grua në Shqipëri, e moshës 34-vjeçare, e infektuar me Covid-19, ka humbur jetën mëngjesin e së mërkurës. "Një 34-vjeçare nga Librazhdi, e cila vuante nga insuficenca renale kronike, diabeti, hipertensioni, e konfirmuar me Covid-19 [sëmundjen që e shkakton koronavirusi], e shtruar në shërbimin infektiv [në Tiranë] prej disa ditësh, në gjendje të rëndë dhe e intubuar, pavarësisht prej përkujdesjes së mjekëve, nuk ka mundur të mbijetojë", ka thënë Marieta Dervishi nga Instituti i Shëndetit Publik.
Me këtë rast, numri i viktimave nga koronavirusi në Shqipëri ka shkuar në 47. Dervishi, po ashtu, ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit autoritetet në Shqipëri kanë kryer 347 teste për koronavirus, prej të cilave 67 kanë dalë pozitive.
"Vazhdon të ketë sërish shtrime të reja në spitalin infektiv, ku aktualisht po trajtohen 82 pacientë, 14 prej tyre janë në terapi intensive", ka thënë Dervishi.




# Maqedonia e Veriut regjistron tetë viktima dhe 136 të infektuar me Covid-19



**Shkup, 24 qershor** - Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut ka raportuar të mërkurën për tetë persona të vdekur dhe 136 të infektuar me sëmundjen Covid-19, pas testimit të 1 208 mostrave në 24 orët e fundit. Sipas raportit, viktima janë: dy nga Shkupi, dy nga Tetova, dy nga Kumanova dhe nga një nga Velesi dhe Kërçova. Me viktimat e ditës së mërkurë, numri i përgjithshëm i personave që kanë humbur jetën, pas diagnostikimit edhe me Covid-19, ka arritur në 259.
Nga Ministria e Shëndetësisë thonë se 395 persona, apo 11.6 për qind e të prekurve me virus po trajtohen nëpër spitalet e vendit, ndërsa pjesa tjetër ndodhen për shërim në ambiente shtëpiake.
Edhe pse numri i rasteve të reja të të infektuarve me koronavirus është më i lartë sesa numri i të shëruarve, nga Ministria e Shëndetësisë thonë se spitalet e Shkupit kanë kapacitete të mjaftueshme spitalore edhe për 272 pacientë.
Në Maqedoninë e Veriut deri më tani janë testuar 54 456 persona dhe prej tyre 5 445 kanë rezultuar me Covid-19.
Numri i përgjithshëm i personave të infektuar me koronavirus në këtë shtet, që nga fillimi i pandemisë, është 5 445, prej tyre 3 095 janë aktivë, ndërsa 2 091 janë shëruar.

# Mbretëria e Bashkuar 'duhet të jetë e përgatitur për valën e dytë të koronavirusit'

**Londër, 24 qershor** - Autoritetet shëndetësore janë duke bërë thirrje për rishikim urgjent të situatës shëndetësore, për të vërtetuar nëse Mbretëria e Bashkuar është e përgatitur për "rrezikun real" të valës së dytë të koronavirusit.
Në një letër të hapur, të publikuar në revistën shkencore "British Medical Journal", ministrat britanikë janë paralajmëruar që duhen marrë masa urgjente për ta parandaluar humbjen e jetës së njerëzve.
Letra është nënshkruar nga udhëheqës të spitaleve, infermierë dhe mjekë të përgjithshëm. Ky lajm vjen pasi kryeministri britanik, Boris Johnson, ka prezantuar ndryshimet e masave të izolimit në Angli.
Departamenti për Shëndetësi ka thënë se do të vazhdojë t'i shikojë udhëzimet e fundit shkencore dhe do t'i ofrojë Sistemit Kombëtar të Shëndetit në Britani, "gjithçka që i duhet".
Të martën kryeministri Johnson ka thënë se restorantet, kinematë dhe parukeritë do të mund të rihapen më 4 korrik. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", Mbretëria e Bashkuar ka regjistruar 307 682 persona të prekur me koronavirus. Prej tyre, 43 011 kanë vdekur.



# Presidentja e Sllovakisë futet në vetizolim



**Bratislava, 24 qershor** - Presidentja e Sllovakisë, Zuzana Caputova, është futur në vetizolim, pasi një prej ndihmësve të saj ka qenë në kontakt me një person që ka dalë pozitiv në testin për koronavirus.
Caputova do të jetë në vetizolim deri të premten, si masë paraprake, tha zëdhënësi i saj. Presidentja i anuloi të gjitha angazhimet, përfshirë edhe takimet e së mërkurës me udhëheqësin e Senatit të Republikës Çeke, Milos Vystrcil, dhe me presidentin e Austrisë, Alexander Van der Bellen.
Sllovakia është lavdëruar për masat që ka ndërmarrë për frenimin e koronavirusit. Ajo ka qenë një nga vendet e para në Evropë që ka mbyllur kufijtë dhe e ka bërë të detyrueshme vendosjen e maskës. Sllovakia, vend me 5.5 milionë banorë, ka konfirmuar deri më tash 1 589 raste me koronavirus.
Shumica prej tyre tashmë janë shëruar, ndërsa 28 të infektuar kanë humbur jetën.

## Bullgaria vazhdon gjendjen e jashtëzakonshme deri në mes të korrikut

Sofje, 24 qershor - Bullgaria do ta zgjasë gjendjen e jashtëzakonshme, të shpallur në përgjigje të koronavirusit, deri më 15 korrik, për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve të rinj, ka njoftuar të mërkurën ministri bullgar i Shëndetësisë, Kiril Ananiev. Bullgaria ka nisur t'i relaksojë masat kufizuese këtë muaj, por javën e kaluar ka raportuar për 606 raste të reja me koronavirus, që është numri më i lartë javor prejse ka nisur pandemia në mes të marsit.
Të mërkurën u regjistruan edhe 130 raste të reja, të cilat e çojnë në 4 114 numrin e përgjithshëm. Prej të infektuarve, deri më tash 208 veta kanë humbur jetën.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# BDI-ja prezanton Naser Ziberin kandidat për kryeministër të Maqedonisë së Veriut

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka prezantuar të mërkurën Naser Ziberin politikanin që do të tentojë të bëhet kryeministri i parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut në zgjedhjet e 15 korrikut. Ky prezantim ka ardhur ditën e nisjes së fushatës elektorale në Maqedoninë e Veriut teksa BDI-ja do të hyjë në zgjedhje pa koalicion



"Epoka e re"

**Shkup, 24 qershor** - Edhe pse ishin lakuar shumë emra që do të propozoheshin për pozitën e kryeministrit shqiptar, lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, të mërkurën, gjatë konventës së BDI-së në Prespë, ka propozuar ish-funksionarin e lartë të PPD-së, Naser Ziberi, kandidat për kryeministër. Nominimi i Naser Ziberit ka ardhur me pëlqimin e Ali Ahmetit dhe mbarë opinionit shqiptar pas shumë anketave të realizuara.

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, i cili e ka nisur fushatën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 15 korrikut, në konventën promovuese në Prespë shpalosi emrin e shumëpritur për kryeministër të parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut, ish-deputetin dhe nënkryetarin e qeverisë dhe bashkëpërpiluesin e Marrëveshjes së Ohrit, Naser Ziberi. "Pas konsultimeve intensive me shoqërinë civile, botën akademike, ekspertë dhe opinionin krijues, por edhe me miq e dashamirë, arritëm deri te emri unifikues dhe meritor për të qenë i pari shqiptar që garon për ta thyer edhe kornizën e fundit një-etnike në Maqedoninë e Veriut, atë të kryeministrit të vendit dhe ky është Naser Ziberi i cili i ka të gjitha virtytet për t'i prirë ekzekutivit të vendit drejt barazisë së plotë", ka thënë Ahmeti.

Ndërsa kandidati për kryeministër në fjalën e tij u shpreh i bindur se ka ardhur koha për barazi të plotë. "Më befasoi thirrja e z. Ali Ahmeti, me ftesë për takim në zyrën e tij. Më njoftoi që ishte konsultuar me shumë njerëz të respektuar të shoqërisë civile dhe akademikë, se emri im ishte ndër të propozuarit si kandidat mbipartiak. U befasova dhe u ndjeva i vlerësuar. Për të qenë plotësisht i sinqertë, mendova se kjo jo vetëm do ta ndryshonte jetën time, por ishte një përgjegjësi mjaft e madhe. Një vendim jo i thjeshtë për t'u marrë dhe jo shumë kohë për ta menduar. Por, çeliku kalitet në zjarr dhe individi vlerësohet për nga vendimet që i merr për të mirën shoqërore përballë rehatisë individuale, andaj thashë po", ka deklaruar Ziberi.

Naser Ziberi ka lindur në vitin 1961 në fshatin Llaskarcë të Shkupit, Komuna e Sarajit. Ka përfunduar Fakultetin Juridik dhe aktualisht ushtron profesionin e noterit. Ziberi në të kaluarën ka qenë funksionar i lartë i PPD-së.

Mbahet sesioni i shtatë plenar i Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL)

# Osmani: Popullit të Kosovës duhet t'i jepet liberalizimi i vizave

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në punimet e sesionit të shtatë të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL), ka thënë se BE-ja nuk ka arritur ta përmbushë premtimin e vet për t'i dhënë popullit të Kosovës liberalizimin e vizave. "Është koha që BE-ja t'i përmbahet marrëveshjes. Popullit tonë duhet t'i jepet liberalizimi i vizave nëse BE-ja do ta ruajë besueshmërinë e vet në rajon", është shprehur Osmani




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 24 qershor** - Të mërkurën është mbajtur sesioni i shtatë i Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore. Gjatë mbajtjes së punimeve online të këtij sesioni të PBEJL-së, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova është e nderuar që këtë vit është nikoqire e kësaj organizate. "Për fat të keq, ne nuk patëm mundësi që t'ju mirëprisnim këtë vit në Prishtinë për shkak të kësaj pandemie vdekjeprurëse me të cilën po ballafaqohemi të gjithë", ka thënë Osmani.

Duke folur për bashkëpunimin rajonal, ajo ka theksuar se aleancat strategjike mund të na ndihmojnë të gjithëve që të strukturohemi më mirë dhe të na ndihmojnë t'i rimendojmë modalitetet tona të bashkëpunimit. "Për më tepër dhe, më e rëndësishmja, më lejoni të theksoj ato që them në punën time të përditshme dhe në çdo takim që kemi me kolegë nga rajoni, nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara dhe më gjerë, ashtu siç të gjithë ne e kuptojmë që paqja, stabiliteti dhe demokracia janë thelbësore, duhet të kuptojmë se nuk mund të këtë paqe dhe pajtim pa drejtësi për viktimat", ka thënë Osmani.

Kryetarja e Kuvendit ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Ajo ka thënë se BE-ja nuk ka arritur ta përmbushë premtimin e vet për t'i dhënë popullit të Kosovës liberalizimin e vizave. "Me gjithë përparimin e bërë, Bashkimi Evropian nuk ka arritur ta përmbushë premtimin e vet për t'i dhënë popullit të Kosovës liberalizimin, tejet të vonuar, të vizave. Ende deri më sot, pavarësisht prej të gjitha përpjekjeve tona dhe arritjeve të njohura, 2 milionë kosovarë, një nga popujt më proevropian, ju kujtojmë janë shkëputur nga pjesa tjetër e Evropës, duke kërcënuar me dekurajim apo zhgënjim nga BE-ja", ka deklaruar Osmani, duke shtuar se, fatkeqësisht, populli i Kosovës ende nuk mund të udhëtojë lirshëm në BE, pavarësisht se e ka kryer punën e vet që një kohë të gjatë. "Është koha që BE-ja t'i përmbahet marrëveshjes. Popullit tonë duhet t'i jepet liberalizimi i vizave nëse BE-ja do ta ruajë besueshmërinë e saj në rajon", është shprehur Osmani.

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR KA DËRGUAR NË DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS, ME SELI NË

# FILLIM I RI ME AKTAKUZA





Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës aktakuzë për presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, dhe për kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli. Në njoftimin për media të ZPS-së është thënë se Thaçi, Veseli dhe të tjerët (nuk përmenden emra) akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte. Sipas aktakuzës, e cila ende nuk është konfirmuar, të dyshuarit janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje. Avokati Tomë Gashi ka vlerësuar se Gjykata Speciale e ka bërë publike këtë aktakuzë në kundërshtim me rregullat e saj ligjore pasi, sipas tij, është dashur të konfirmohet nga gjyqtari i procedurës paraprake. Presidenti Thaçi e ka anuluar pjesëmarrjen në takimin me Serbinë në Uashington pas ngritjes së aktakuzës nga Specialja. Ndaj kësaj aktakuze ka pasur reagime të shumta nga përfaqësues të politikës, të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe nga shoqëria civile

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar të mërkurën ka dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, akuzohen për krime lufte.

Në një komunikatë për media, Zyra e Prokurorit ka bërë me dije se Thaçi, Veseli dhe të dyshuarit e tjerë janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme. "Më 24 prill 2020 Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ua paraqiti Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim prej Gjykatës, ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të tjerë akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte, ndër të cilat, për vrasje të paligjshme, për zhdukje të detyruar të personave, për përndjekje dhe tortura. Në aktakuzë pretendohet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të dyshuar të tjerë janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme", është thënë në njoftimin e ZPS-së.

Një gjykatës i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës është duke e shqyrtuar aktakuzën për të vendosur nëse do t'i konfirmojë akuzat. "Krimet e paraqitura në aktakuzë përshijnë qindra viktima të identifikuara shqiptarë, serbë dhe romë të Kosovës dhe kundërshtarë politikë. Aktakuza është vetëm një padi penale e cila është rezultat i një hetimi të gjatë dhe dëshmon vendosmërinë e ZPS-së se mund t'i provojë të gjitha akuzat jashtë dyshimit të arsyeshëm. Një gjykatës i procedurës paraprake i DHSK-së është duke e shqyrtuar aktakuzën për të vendosur nëse do t'i konfirmojë akuzat", është thënë në njoftim.

Në fund të njoftimit është bërë me dije arsyeja e publikimit të kësaj aktakuze. "Prokurori i Specializuar e gjykon të domosdoshëm nxjerrjen e këtij njoftimi publik për akuzat për shkak të përpjekjeve të përsëritura të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit për pengimin dhe sabotimin e punës së DHSK-së. Besohet se z. Thaçi dhe z. Veseli kanë ndërmarrë në fshehtësi një fushatë për shfuqizimin e ligjit që krijoi Gjykatën dhe ndryshe kanë penguar punën e Gjykatës në orvatje për t'i bishtnuar drejtësisë. Nëpërmjet këtyre veprimeve, z. Thaçi dhe z. Veseli kanë vënë interesat e tyre vetjake mbi viktimat e krimeve të tyre, sundimin e ligjit dhe popullin e Kosovës", është thënë në njoftim.

### Aktakuzë politike

Publikimi i aktakuzës, pa u konfirmuar nga gjyqtari i procedurës paraprake, ka nxitur reagime të shumta në vend. Madje publikimi i saj pak kohë para nisjes së presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, drejt Uashingtonit, për t'u takuar me zyrtarët serbë, është vlerësuar politike.

Avokati Tomë Gashi ka vlerësuar se Gjykata Speciale e ka bërë publike aktakuzën për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin në kundërshtim me rregullat ligjore. Në profilin e vet në "Facebook", Gashi ka shkruar se aktakuza nuk është dashur të publikohet pa u konfirmuar nga gjyqtari i procedurës paraprake. Sipas tij, ngritja e kësaj aktakuze është lajm i keq për shqiptarët e Kosovës. "Gjykata Speciale e bëri publike aktakuzën e parë të ngritur nga Zyra e Prokurorit Special në kundërshtim me rregullat e saj ligjore. Aktakuza e ngritur nga Prokuroria dhe e dorëzuar në Gjykatë Speciale në Hagë ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli është ende e pakonfirmuar nga

HAGË, AKTAKUZË PËR PRESIDENTIN HASHIM THAÇI DHE PËR KRYETARIN E PDK-SË, KADRI VESELI

# TË VJETRA POLITIKE



gjyqtari i Procedurës Paraprake. Është një lajm i keq për të gjithë shqiptarët në përgjithësi, për ne shqiptarët e Kosovës në veçanti, posaçërisht për ish-pjesëtarët e UÇK-së", ka shkruar Gashi.
Ndaj këtij lajmi ka reaguar edhe ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së, politologu Bardhyl Mahmuti, i cili ka thënë se deklarata politike nga Zyra e Prokurorit të Specializuar është dëshmi e pakontestueshme se Gjykata Speciale është gjykatë politike antishqiptare. "Në këtë mënyrë, nëpërmjet kësaj deklarate politike, ende pa filluar procesi gjyqësor, zyra e prokurorit të specializuar shpall vendimin Hashim Thaçi dhe Kadri Veselin si kriminelë dhe paragjykon se 'qindra viktima të identifikuara shqiptarë, serbë dhe romë qenkëshin viktima të krimeve të tyre'!!! Ky qëndrim politik në kundërshtim me parimet bazë të drejtësisë dëshmon se e ashtuquajtura Gjykatë Speciale nuk është asgjë tjetër pos një gjykatë politike antishqiptare!", ka shkruar Bardhyl Mahmuti në llogarinë e vet në "Facebook".
Edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka kritikuar njoftimin për media të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në të cilin është bërë me dije aktakuza ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli.
Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se ajo deklaratë më shumë i është dukur si pamflet politik sesa një deklaratë me elemente juridike. "Deklarata publike e Zyrës së Prokurorit të Specializuar m'u duk më shumë një pamflet politik sesa një deklaratë me elemente juridike. Ma çoi mallin e disa kohëve të tjera kur roli i prokurorive ishte edhe politik. Pak është të them se mbeta i habitur nga kjo deklaratë dhe jo profesionalizmi i saj", ka shkruar Murati.
Ndërsa kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hyseni Gucati, ka thënë se një veprim i tillë është kryekëput politik. "Kadri Veseli ka qenë më herët i intervistuar nga Gjykata Speciale, Hashim Thaçi nuk ka qenë. Unë mendoj që ky është veprim politik nga Gjykata Speciale pak para nisjes për në Uashington. Këto për ne janë të papranueshme. Është e pamundur që Thaçi dhe Veseli të kryejnë vrasje ndaj 100 njerëzve", ka thënë Gucati.
Lajmi për ngritjen e aktakuzave nga Gjykata Speciale vjen pak kohë para nisjes së presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi drejt Uashingtonit, për t'u takuar me zyrtarët serbë, me ndërmjetësim të të dërguarit të Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell.

### Lufta e UÇK-së ishte e pastër

Liderët e partive politike kanë reaguar pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës aktakuzë për presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli, për krime lufte. Ata janë shprehur se besojnë në pafajësinë e tyre dhe në pastrinë luftës së UÇK-së.
Lider i LV-së, Albin Kurti, pa përmendur emrat e Thaçit dhe Veselit, ka thënë se lufta e UÇK-së është e drejtë. "E di që lufta e UÇK-së është luftë e drejtë, është luftë kundër një agresori dhe okupatori i cili kishte kryer gjenocid në vendin tonë dhe se luftëtarët e lirisë, veteranët e invalidët e UÇK-së, edhe politikisht edhe historikisht janë në të drejtën e tyre", ka deklaruar Kurti në një konferencë për media.
Ndërsa lideri i LDK-së, Isa Mustafa, në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se beson thellë se lufta e UÇK-së ishte e drejtë. "Besoj thellë se lufta e UÇK-së ishte dhe do të konfirmohet nga drejtësia ndërkombëtare si luftë e drejtë dhe e pastër, se luftëtarët e UÇK-së luftuan për ta mbrojtur popullin e Kosovës nga terrori, likuidimi dhe gjenocidi serb", ka shkruar Mustafa.
Edhe ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se UÇK-ja ka bërë luftë të pastër. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë të pastër, rezultate të së cilës ishin liria dhe themelimi i Republikës së Kosovës. Ne besojmë në pafajësinë e presidentit Thaçi, kryetarit Veseli dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tjerë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".
Ndaj këtij lajmi ka reaguar edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i cili ka thënë se lufta e UÇK-së, që iu imponua popullit të Kosovës nga shtypja dhe gjenocidi i regjimit kriminal të Millosheviqit, rezultoi se ishte e drejtë dhe vendimtare jo vetëm për lirinë dhe themelimin e Republikës së Kosovës në kufijtë e njohur ndërkombëtarisht, por edhe për paqen, stabilitetin dhe ardhmërinë e saj evropiane dhe të rajonit tonë. "Ne besojmë në pafajësinë e presidentit Hashim Thaçi, ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tyre. Edhe më parë janë ngritur akuza ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së, por pafajësia e tyre dhe drejtësia e luftës është konfirmuar. Ne besojmë se kjo do të ndodhë përsëri", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

## Thaçi anulon vizitën në Uashington, Kosovën e përfaqëson Hoti

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka anuluar pjesëmarrjen në takimin me Serbinë në Uashington, të planifikuar më 27 qershor, pas ngritjes së aktakuzës nga Specialja. Në një njoftim për media, Zyra e Presidencës ka bërë me dije se Thaçi ka ndërprerë udhëtimin për në ShBA dhe të enjten do të kthehet në Kosovë.
I dërguari i posaçëm i ShBA-së, Richard Grenell, ka thënë se e mirëkupton vendimin e Thaçit dhe ka bërë me dije se, megjithatë, takimi do të mbahet me pjesëmarrjen e kryeministrit Avdullah Hoti dhe presidentit serb Aleksandar Vuçiq.
"Presidenti i Kosovës sapo na ka njoftuar se e ka anuluar udhëtimin për në Uashington, pas njoftimit nga Zyra e Prokurorit Special. E respektoj vendimin e tij për të mos marrë pjesë në diskutime derisa të zgjidhen këto çështje. Presim diskutimet e së shtunës të cilat do të udhëhiqen nga presidenti Vuçiq dhe kryeministri Hoti", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Twitter".

# Dorëzohet puna shumëvjeçare projektuese e arkitektit Ramadan Emini

Ferizaj, 24 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka pritur në takim vajzën e veprimtarit të çështjes kombëtare e të arkitektit Ramadan Emini, Majlinda Emini-Çalaj. Me këtë rast, ajo ia ka dorëzuar Aliut projektet të cilat i ka lënë i ndjeri Ramadan Emini. "Janë veprat, projektet, idetë e shkruara e skicat që i ndjeri Ramadan Emini ia la trashëgim familjes për t'ua dhuruar institucioneve lokale pas vdekjes së tij. E pikërisht këtë amanet, këtë dëshirë të tij, e përmbushi vajza e të ndjerit, Majlinda Emini-Çalaj, e cila i dorëzoi këto dokumente tek i pari i Ferizajt, Agim Aliu. Ky i fundit, në pritjen që i rezervoi vajzës së shembullit të rrallë të veprimtarit e arkitektit, familjes patriotike të tij, tha se këto vepra, punime e projekte të Ramadan Eminit do të ruhen e përdoren si vlerë e çmuar intelektuale e profesionale, për të shërbyer në të tashmen dhe të ardhmen si vlera të kohës", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Arkivi personal, i cili është dorëzuar të mërkurën, do të sistemohet dhe ruhet veçanërisht në institucionet përgjegjëse komunale.



# Shpërndahen rreth 400 maska, doreza dhe fletushka informative për qytetarët e Mitrovicës



Mitrovicë, 24 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka dhe drejtorin e Arsimit, Egzon Jashari, kanë marrë pjesë të mërkurën në aktivitetin e organizuar nga Platforma Civikos në bashkëpunim me OJQ-në "Mundësia", CBM, Open Data Kosovo dhe nxënësit e Shkollës së Mesme Ekonomike "Hasan Prishtina" në Mitrovicë.

Ky aktivitet simbolik kishte për qëllim realizimin e fushatës vetëdijësuese "vendosemaskën", me ç'rast kryetari Bahtiri dhe nënkryetari Mujka së bashku me disa nxënës kanë shpërndarë maska, doreza dhe broshura informative për qytetarët kalimtarë në sheshet e Mitrovicës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e përdorimit të maskave në ambiente publike për t'u mbrojtur nga virusi Covid-19 me të cilin përballet e gjithë bota. Me këtë rast, kryetari Bahtiri i ka përgëzuar organizatat në fjalë si dhe nxënësit për iniciativën e ndërmarrë, duke thënë se këto aktivitete luajnë rol të rëndësishëm në vetëdijesimin e qytetarëve sepse në këtë mënyrë mbrohet vetë shëndeti i tyre, familjarëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

# Rikthehet tregu mobil në Prishtinë

Prishtinë, 24 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se, pas një pauze disamujore për shkak të pandemisë Covid-19, do të rihapet tregu mobil në kryeqytet. "Prej kësaj jave do të vazhdojë t'ju ofrojë pemë, perime dhe produkte të freskëta vendore të kultivuara me shumë kujdes e dashuri nga fermerët tanë. Vizitoni dhe konsumoni prodhimet vendore. Ushqehuni shëndetshëm dhe mbështetni fermerët e Prishtinës", ka deklaruar Ahmeti.

Tregu mobil në kryeqytet do të punojë çdo të martë, mërkurë dhe të enjte nga ora 9:00-17:00 në sheshin "Zahir Pajaziti", sheshin "Bill Clinton" në lagjen "Dardania" dhe në sheshin "Adem Jashari" tek plateja e Komunës së Prishtinës.





# Ambasada e Japonisë i dhuron një kamionetë Suharekës

Suharekë, 24 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se kjo komunë ka pranuar një donacion në vlerë rreth 70 mijë euro nga Ambasada e Japonisë në Kosovë. Muharremaj ka thënë se ky donacion është dhuruar falë bashkëpunimit dhe performancës së mirë të komunës që drejton. "69 500 euro është vlera e kamionetës që sot u dhurua nga Ambasada Japoneze në Republikën e Kosovës për Njësinë e Zjarrfikësve në Suharekë. Ky donacion dhurohet falë bashkëpunimit dhe performancës së mirë të Komunës së Suharekës. Ne jemi falënderues dhe mirënjohës për kontributin e Ambasadës së Japonisë dhe popullit japonez", ka thënë Muharremaj.

# Lansohet aplikacioni ‘Lajmëro policinë’




**Policia e Kosovës ka lansuar të mërkurën aplikacionin “Lajmëro policinë”. Ky projekt do të jetë edhe një mundësi tjetër alternative për qytetarët për raportim sa më të shpejtë të rasteve të ndryshme dhe avancimit të mëtejmë të bashkëpunimit dhe komunikimit me Policinë e Kosovës**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Policia e Kosovës të mërkurën ka lansuar aplikacionin “Lajmëro policinë”. Ky projekt do të jetë edhe një mundësi tjetër alternative për qytetarët për raportim sa më të shpejtë të rasteve të ndryshme dhe avancimit të mëtejmë të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës.

Në lansimin e këtij aplikacioni morën pjesë drejtori i Përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj, kryesuesi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu, zëdhënësi i policisë, Baki Kelani dhe përfaqësues nga Divizioni për Siguri Publike të PK-së.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se ndihma këtë herë do të jetë digjitale. “Lajmërimet tash do të jenë më konfidenciale. Ky aplikacion është i rëndësishëm edhe për efikasitetin e policisë sepse tash do të jenë edhe më të shpejtë për ndihmë ndaj qytetarëve. Ky do të jetë përafrim i qytetarit me policinë”, ka deklaruar Qalaj.

Ndërkaq ambasadori Jan Braathu ka thënë se OSBE-ja do ta vazhdojë ndihmën ndaj Policisë së Kosovës. Sipas tij, me lansimin e këtij aplikacioni do të rritet ndihma e policisë ndaj qytetarëve. “OSBE-ja prej fillimit ka ndihmuar policinë dhe këtë ndihmë do ta vazhdojë. Sot përmes teknologjisë informative është lehtësuar çdo raportim. Nganjëherë duam të raportojmë diçka, por nuk dimë si ta bëjmë, e një mënyrë e tillë si kjo me aplikacion e lehtëson atë. Tash kemi lansuar këtë aplikacion që ju mundëson të gjithëve t’i raportoni krimet, dhunën dhe trafikimet”, është shprehur Braathu, duke shtuar se ky aplikacion do ta ndihmojë policinë që të mbërrijë sa më parë në vendin e ngjarjes. “Në aplikacion mund të dërgoni edhe fotografi nga ndonjë vend i ngjarjes. Jam krenar me punën e Policisë së Kosovës. Kemi nevojë që policia të jetë sa më afër qytetarit”, ka thënë Braathu.

Zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë theksuar se përdorimi i këtij aplikacioni siguron informacion, saktësi dhe efikasitet. Ky aplikacion mund të shkarkohet në “Play Store”.

# Veliu: Qytetarët të qëndrojnë sa më larg armëve ilegale dhe dhunës




**Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, në takimin e tretë lokal koordinues për implementimin e udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme të armëmbajtjes pa leje dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta, u ka bërë thirrje qytetarëve që të qëndrojnë sa më larg armëve ilegale dhe dhunës në përgjithësi**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të mërkurën takimi i tretë lokal koordinues për implementimin e udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme të armëmbajtjes pa leje dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor.

Me këtë rast, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, në cilësinë e koordinatorit nacional për kontrollin e armëve të lehta dhe kontrollin e eksplozivëve, ka thënë se MPB-ja është e interesuar që ta implementojë udhërrëfyesin në përpikëri dhe ta zbatojë planin e veprimit të strategjisë.

“Ne mburremi me sukseset dhe profesionalizmin e Pikës së Kontaktit për Armë (FFP) në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila në mënyrë brilante kryen detyrat dhe angazhimet në fushën e shkëmbimit të informatave, në kohë reale, me institucionet kompetente, gjurmimin kombëtar dhe ndërkombëtar, prodhimin e raporteve si dhe produkteve inteligjente në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta. Pika e Kontaktit për Armë shërben edhe si një praktikë shumë e mirë në rajon”, ka deklaruar ministri Veliu.

Gjatë këtij takimi ministri Veliu ka falënderuar donatorët dhe partnerët për kontributin e tyre bujar, në veçanti Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe Francës, UNDP-në në Kosovë si dhe SEESAC për përkrahje të vazhdueshme në këtë fushë, por edhe për këshillat profesionale dhe përkrahjen teknike.

Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të punëve dhe angazhimeve në fushën e kontrollit dhe minimizimit të armëve ilegale, ministri Veliu ka kërkuar përkrahjen e mëtejmë të tyre edhe në fushën e luftimit të armëve ilegale në aspektin e hetimeve policore. Gjithashtu, ministri Veliu u bëri thirrje qytetarëve të Republikës së Kosovës të qëndrojnë sa më larg armëve ilegale dhe dhunës në përgjithësi, për një Kosovë dhe një rajon më të sigurt.

# Ministri Zemaj nis vizitat nëpër komuna

GJILAN, 24 QERSHOR - Në kuadër të vizitave nëpër komuna, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, të mërkurën ka qëndruar në Gjilan. Gjatë takimit me kryetarin e komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, Zemaj ka treguar se në këtë takim kanë biseduar për situatën aktuale me pandeminë Covid-19 dhe koordinimin që kanë si ministri me komunat për menaxhimin sa më të mirë të situatës aktuale. "U zotuam që Qeveria e Kosovës do të jetë pranë qytetarëve në këtë betejë me të cilën po përballet i gjithë rajoni dhe bota. Me kryetarin Haziri biseduam edhe për lehtësimin e masave që qeveria ka marrë, veçmas për lejimin e linjave ajrore dhe tokësore, në mënyrë që t'i mundësohet mërgatës sonë ardhja në vendlindje", ka thënë Zemaj.

Ai ka thënë se gjatë kësaj vizite Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan, i dhuruan një autoambulancë, donacion i Bashkimit Evropian. "Si ministër do t'i vazhdoj vizitat në secilën komunë, duke shprehur përkushtimin për avancimin e sistemit shëndetësor në nivel lokal dhe qendror dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët tanë. Kujdesi për shëndetin e qytetarëve është prioriteti ynë", ka thënë ministri Zemaj.




# Kurti: Në qeverisjen tonë i ndihmuam komunitetet pakicë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, mori pjesë të mërkurën në tryezën "Integrim apo gjithëpërfshirje?!" organizuar nga Partia Egjiptiane - IRDK, me rastin e Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit.

Kurti ka thënë se problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës pësohen të përshkallëzuara nga ata që janë të varfër dhe rëndojnë edhe më shumë mbi komunitetet joshumicë dhe në këtë rast edhe mbi atë egjiptian. "Problemet e përditshme duhet të na bashkojnë dhe jo të na ndajnë, sepse askush për nga natyra nuk është përcaktuar të jetë fatalisht i varfër, por bëhet i tillë për shkak se dikush tjetër është pasuruar. Askush nuk ka zgjedhur të lindë grua apo burrë, shqiptar apo diçka tjetër, në Kosovë apo gjetiu, prandaj duhet që bashkërisht të kërkojmë zgjidhje", ka thënë Kurti.

Ai ka folur edhe për qeverisjen e Vetëvendosjes që i ka ndarë 593 bursa për fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. "Në qeverisjen tonë, qeverisjen më të mirë që kishte vendi, për aq sa patëm mundësi u fokusuam në ndihmesë konkrete për komunitetet pakicë në vend. Përderisa shumica e fëmijëve egjiptianë, ndonëse vijojnë



mësimet në gjuhën shqipe, kanë tendenca për ta lënë shkollimin më herët për këto arsye: statusi i ulët socio-ekonomik, mungesa e shkollave të cilësisë së lartë, infrastruktura e dobët arsimore dhe herë pas here mungesa e transportit. Kësisoj, qeveria jonë mori vendim që të ndajë 593 bursa për fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Nuk është e mjaftueshme, por duhej të fillonim nga diku", është shprehur Kurti.

Ai bëri thirrje që komunitetet joshumicë, në këtë rast ai egjiptian, të organizohet e ta imponojë veten sa më shumë në jetën publike e politike, si duke shtruar kërkesa ashtu edhe duke propozuar zgjidhje e duke treguar vendosmëri për t'i zgjidhur problemet me të cilat ballafaqohet. "Koha e qeverive që varfërojnë popullin dhe jo vetëm komunitete të caktuara po ikën. Kanë provuar të ndërtojnë dinasti prej kartoni, por ja që rrebeshi i ndryshimit po ua rrëzon ato", ka thënë Kurti në fund të fjalës së tij.




# 85 pacientë të shtrirë në Klinikën Infektive me Covid-19

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës aktualisht janë të shtrirë 85 pacientë me Covid-19. Në raportin e Infektivës thuhet se 42 raste janë duke u trajtuar në reparte me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, ndërsa në repartin e mjekimit intensiv janë duke u trajtuar gjashtë raste në gjendje kritike. "Sot nga klinika do të lirohen tetë raste të shëruara nga infeksioni me Covid-19 si dhe dy raste ende pozitive, por në gjendje stabile", thuhet në raport.

Po ashtu, bëhet me dije se në njësinë intensive tek objekti i Mjekësisë Sportive janë tre pacientë. "Në Klinikën e Pulmologjisë dhe Dermatologjisë janë të shtrirë 22 raste të dyshuara me Covid-19 dhe 4 raste me Covid-19 që pritet të transferohen në Klinikën Infektive", është bërë me dije në këtë raport.

Në Kosovë janë konfirmuar gjithsej 2 268 raste me Covid-19. Prej tyre, 1 108 janë shëruar dhe 38 kanë vdekur.

## Osmani pranon mirënjohje nga deputeti Veton Berisha

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të Ditës së Komunitetit Egjiptian, ka pritur të mërkurën një delegacion të kryesuar nga deputeti Veton Berisha.

Kryetarja Osmani e ka uruar komunitetin egjiptian në ditën e vet dhe e ka falënderuar për kontributin në shtetndërtimin e Kosovës. Ajo ka thënë se diversiteti kulturor, etnik dhe religjioz janë të rëndësishme për promovim të vlerave të shoqërisë.

Ndërkaq deputeti Veton Berisha në emër të këtij komuniteti i ka dhënë një mirënjohje kryetares Osmani dhe ka kërkuar që dita e këtij komuniteti të përfshihet në kalendarin e festave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në këtë takim, deputeti Berisha ka përmendur problemet e komunitetit egjiptian me përfshirjen në jetën institucionale dhe mospërfshirjen e fëmijëve të këtij komuniteti në mësimin online.



## "Humanity First" dhuron materiale mbrojtëse për Sindikatën e Pavarur të Doganës

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Të mërkurën organizata Humanity First dhe shoqata AMJ kanë dorëzuar donacionin me pajisje mbrojtëse kundër koronavirusit në ambientet e Doganës së Kosovës në Prishtinë. Ky donacion u dhurua pasi ishte nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Prishtinës, Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës dhe "Humanity First" për qëllim ofrimin e materialeve mjekësore-higjienike mbrojtëse për parandalimin e infektimit me Covid-19.
Këto pajisje mbrojtëse, që dedikohen për zyrtarët doganorë të Kosovës, përfshijnë: 395 shishe me përbërje alkooli (rreth 40 litra), 350 shishe dezinfektues për duar (87.5 litra) dhe 20 shishe dezinfektues për dysheme (100 litra).
Gjatë pranimdorëzimit të materialit ishin të pranishëm: përfaqësuesi i organizatës "Humanity First", koordinatori për projekte i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale i Komunës së Prishtinës, Premtim N. Fazliu, kryetari i Sindikatës së Pavarur i Doganës së Kosovës, Ali Vitija dhe nënkryetari i këtij Sindikate, Kujtim Krasniqi.
Në fund të takimit, kryetari i Sindikatës, Ali Vitija, ka falënderuar organizatën "Humanity First" për këtë donacion. "Shpresoj se në të ardhmen do t'i thellojmë bashkëpunimet edhe në fusha të tjera", ka thënë Vitija.
Vlen të theksohet se para dymuajsh kishte ndërruar jetë një oficer i Doganës së Kosovës i cili ishte infektuar me virusin Covid-19, ndërsa deri më sot katër oficerë doganorë janë të infektuar, ndërsa tre të tjerë gjenden në vetizolim.



# Komisioni për Buxhet shqyrtoi raportin vjetor financiar të Aviacionit Civil dhe të Autoritetit Rregullativ të Ujit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Komisioni për Buxhet dhe Transfere, drejtuar nga kryetari Hekuran Murati, ka shqyrtuar të mërkurën raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2019 dhe raportin financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2019.
Para anëtarëve të këtij komisioni raportin financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2019 e ka prezantuar zëvendësdrejtori Xhelil Bekteshi. Përveç arsyetimit të shpenzimeve për stafin e këtij institucioni, si sfidë me të cilën përballet, Bekteshi ka theksuar mungesën e objektit.
Ndërsa deputetët u interesuan për shpenzimet e mëdha për trajnime të stafit të Autoritetit të Aviacionit Civil si dhe shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës nga shteti hungarez, me ç'rast, sipas tyre, për shkak të mosinkasimit, shkaktohen humbje milionëshe.
Raporti financiar i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2019 mori miratimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe i njëjti i rekomandohet Kuvendit për miratim.
Në vijim, raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2019 e ka prezantuar drejtori Raif Preteni. Edhe Preteni ka theksuar se një shumë e konsiderueshme e buxhetit të këtij institucioni përdoret për pagesën e qirasë së objektit.
Duke u përgjigjur në interesimin e deputetëve lidhur me humbjet e mëdha të ujit, Preteni ka thënë se humbjet e ujit për vitin 2019 janë 57 për qind e që, sipas tij, kanë ndodhur për shkak të vjedhjeve dhe punës joefikase të kompanive rajonale të ujësjellësit.
Edhe raporti financiar vjetor i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit mori votat e të gjithë anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Transfere.
Komisioni, po ashtu, ka shqyrtuar propozimin e panelit seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së.
Kryetari Hekuran Murati ka thënë se qeveria i ka rekomanduar Kuvendit që të mos i marrë parasysh dy kandidatura nga gjashtë sa janë dërguar nga paneli seleksionues pasi, sipas tij, janë pjesë e stafit të BQK-së e që përzgjedhja e tyre është në kundërshtim me ligjin.
Në këtë pikë pati debat ndërmjet anëtarëve të komisionit nëse duhet hequr nga lista këta dy kandidatë apo jo. Në fund propozimi i panelit seleksionues u hodh në votim dhe me tri vota kundër dhe 7 për, komisioni procedoi për seancë listën prej gjashtë kandidatëve për plotësimin e një anëtari joekzekutiv të bordit të BQK-së, e cila ka ardhur nga vetë paneli vlerësues i BQK-së.

## Krasniqi: Prioriteti im, mbështetja e prodhuesve vendorë

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur në takim kryetarin e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skender Krasniqin, me bashkëpunëtorë. Ministri Krasniqi i ka informuar përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës për objektivat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për mundësitë e mbështetjes së bizneseve kosovare për ta kaluar krizën e shkaktuar nga pandemia.
Ministri Krasniqi u zotua se ndër prioritetet e tij më të rëndësishme janë mbështetja e prodhuesve vendorë dhe fuqizimi i tyre në eksport përmes programeve përkrahëse që i ka Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Po ashtu, ministri iu shpjegoi përfaqësuesve të OAK-ut për pakot mbështetëse të Qeverisë së Kosovës për t'u dalë në ndihmë bizneseve, të cilat parashihet të implementohen në vitin 2021, duke i përfshirë rreth 70 për qind të bizneseve.
Në takim u diskutua edhe për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të OAK-ut dhe MTI-së për tejkalimin e sfidave që i kanë bizneset.



# Marrëveshja madhështore NATO-RFJ 1999 dhe territori i Kosovës



Prof. Dr. Murat MEHA

Për t'i analizuar proceset e zhvillimeve në Kosovë, duke filluar nga viti 1912 e deri te pavarësia e saj në vitin 2008, duhet hulumtim i thellë shkencor mbi atë historiografi. Sidoqoftë, kisha mjaft argumente profesionale dhe shkencore për rikujtimin e marrëveshjes madhështore të datës 9 qershor 1999. Kjo marrëveshje, përveç të tjerave, shumë saktë ndërlidhë aprovimin ndërkombëtar të territorit të Kosovës në të gjitha nivelet deri në Kombet e Bashkuara.

Periudha dhjetëvjeçare 1998-2008 karakterizohet me luftën e ndritshme të UÇK-së, me bombardimet e NATO-s mbi Serbi dhe me mbrojtjen e popullatës civile në Kosovë. Këto ndërlidhën drejtpërdrejt me humanitetin për ndaljen e gjenocidit ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe kulmon me shpalljen e pavarësisë së shtetit. Sigurisht deri në luftën e UÇK-së dhe bombardimet e NATO-s u provuan metoda shteruese që në mënyrë paqësore e me dialog të gjendej një zgjidhje e pranueshme për Kosovën. Meqë zbatimi i metodave paqësore mungoi dhe presioni i Serbisë nuk ndalej ngaqë u kuptua se Serbia nuk pranon zgjidhje paqësore për Kosovën, ajo vazhdonte t'i ashpërsonte metodat e dhunës ndaj popullatës shqiptare, ndaj pronës së tyre, pastaj dëmtimet dhe abuzimet bëheshin në të gjitha fushat e jetës, nëpërmjet ligjeve diskriminuese apo fare pa ligj: në edukim, në kulturë, në ekonomi, në industri etj. Dhuna tejkaloi të gjitha pikat ekstreme, ndaj lindi organizimi i UÇK-së në territorin e Kosovës.

Lufta vazhdonte, sulmet e NATO-s nga ajri mbi Serbi të filluara më 24 mars 1999 vazhduan deri më 10 qershor 1999. Njëkohësisht NATO në krye me ShBA-në bënin oferta për ndërprerje të gjenocidit në Kosovë për t'i krijuar kushtet për fillimin e bisedimeve. Në atë rast pushteti serb kërkonte të kundërtën, paraprakisht ndalja e bombardimeve nga NATO e pastaj bisedimet për marrëveshje. Këtë truk nuk e pranoj ShBA-ja, prandaj sulmet nga ajri vazhduan. Pas 78 ditë sulme nga NATO, Serbia u gjunjëzua dhe pranoi marrëveshjen (lexo kapitullimin) e saj të arritur më 9 qershor 1999 në Kumanovë të Maqedonisë.

**Rrjedhja e nënshkrimit të marrëveshjes.** Para përfundimit të bombardimit të NATO-s mbi RFJ-Serbi, ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari e dorëzon një propozim marrëveshje ushtarake-teknike për t'u aprovuar nga Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR) në njërën anë, kurse në anën tjetër nga të dyja palët: nga Republika Federale e Jugosllavisë dhe nga Republika e Serbisë e përfaqësuar nga kryetari Sllobodan Millosheviq (i cili përfundoi në Gjykatën e Hagës). Parlamentet e këtyre dy të fundit e aprovojnë marrëveshjen më 3 qershor 1999 dhe më 9 qershor 1999 në Kumanovë nënshkruhet marrëveshja ndërmjet gjeneralit të NATO-s dhe atij të RFJ (KFOR-RFJ (Serbi-Mal i Zi). Marrëveshja u nënshkrua nga komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë, gjenerali Michael Jackson dhe ish-shefi i Shtabit të Armatës së RFJ - Serbisë, gjenerali Nebojsha Pavkoviq (i cili më vonë u akuzua për krime lufte dhe gjenocid). Të nesërmen, më 10 qershor, në Këshillin e Sigurimit të KB aprovohet Rezoluta 1244 dhe shpallet përfundimi i luftës me fitore të forcave NATO kundër RFJ. Marrëveshjes dhe Rezolutës i paraprinë aprovimi i procesit nga Grupi G-8 për paqe në Kosovë. Pikat kryesore të aprovuara nga G-8 janë: - Zyrtarët jugosllavë dhe NATO nënshkruajnë marrëveshje ushtarake-teknike për tërheqjen e forcave serbe; - Forcat serbe fillojnë tërheqjen me verifikimin e NATO-s; - NATO pezullon sulmet ajrore; - Derisa forcat serbe largohen, forcat paqeruajtëse të KFOR-it hyjnë në Kosovë; - Këshilli i Sigurimit i KB-së miraton rezolutën që ishte përgatitur dhe aprovuar për planin e paqes nga G-8.

Zakonisht për çështje të ndërlidhura me territore, sikurse në rastin Kosovë - Serbi, marrëveshja përmban dy pjesë: atë tekstuale dhe atë hartografike. Pjesa tekstuale përmban gjashtë nene (article eng.) dhe një shtojcë, ndër të tjera përmban edhe sqarime të ndërlidhura me paraqitjet hartografike, duke u mbështetur ne gjeoinformacionin e saktë. Natyrisht se vlera e hartës është shumë qëllimore dhe shumëdimensionale: për zbatimin e marrëveshjes në terren për vëzhgim, pastaj në raste kontesti në vijën kufitare, për ruajtjen e stabilitetit, lirisë dhe sovranitetit në gjithë territorin e Kosovës. Fakt i ditur është se ushtritë gjithmonë dhe për çdo veprim apo lëvizje të tyre, qoftë për trajnime për luftë apo për paqe, përdorin hartat topografike. Kështu që edhe për nënshkrimin e marrëveshjes së cekur më sipër u përdorën hartat topografike të vitit 1999, me kufirin e paraqitur ndërmjet territorit të Kosovës dhe Serbisë e Malit të Zi. Këto harta topografike të NATO-s rrjedhimisht janë aprovuar së bashku me marrëveshjen në Parlamentin e RFJ dhe në parlamentin e Serbisë, të cilat janë edhe tani në dispozicion.

Marrëveshja ushtarake-teknike në pjesën tekstuale, ndër të tjera, prezanton: 1. "Zona e Sigurisë Ajrore (ASZ-Air safety zone) përcaktohet si një zonë 25 kilometra përtej kufirit të Krahinës së Kosovës në pjesën e territorit të RFJ-së.

Ai territor përfshin zonën 25 kilometërshe të hapësirës ajrore". 2. "Zona e Sigurisë Tokësore (GSZ-Ground safety zone) është përcaktuar si një zonë 5-kilometra që shtrihet përtej kufirit të krahinës së Kosovës në pjesën e territorit të RFJ-së. Ai territor përfshin zonën 5 kilometërshe të hapësirës tokësore". Shiko hartat topografike me sqarime. Dy fleta të hartës topografike për pjesë të territorit të Kosovës të paraqitura në vijim (sepse në tërësi të tilla janë 34 feta), me vijën e kufirit dhe me vijën e zonës se sigurisë, janë nga marrëveshja ushtarake-teknike 9 qershor 1999.

Harta topografike nga marrëveshja 9 qershorit 1999 tregon se Kosova në periudhën e RSF Jugosllavisë kishte territor të përkufizuar me një vijë administrative, apo thënë më mirë kishte kufirin e saj brenda RSF Jugosllavisë. Vijat përkufizuese të prezantuara në hartën me përpjesë 1:50000 janë nga pika 2 për Zonën e Sigurisë Tokësore (GSZ- Ground safety zone), vija e trashe prezanton kufirin e Kosovës, kurse vija e hollë paraqet përkufizimin e zonës tokësore të sigurisë 5 km larg kufirit të Kosovës në thellësi të RFJ. I gjithë territori i Kosovës me kufirin e saj është prezantuar në 34 fleta të hartës topografike të asaj përpjese. Po ashtu, në përpjesën 1:100000, i njëjti territor i Kosovës është paraqitur në 13 fleta të hartës topografike të NATO-s (KFOR). Këto harta janë të përpiluara nga Agjencia Kombëtare e Imazheve dhe Hartave, SHBA (National Imagery and Mapping Agency-NIMA). Rëndësia e përcaktimit të këtyre dy zonave është së paku e trefishtë: sepse nëpërmjet saj janë garantuar: 1. siguria, 2. liria, si dhe 3. për herë të parë në nivel ndërkombëtar është cituar, prezantuar dhe zbatuar kufiri për territorin e Kosovës.

Zhvillimet e tanishme të teknologjisë se avancuar →







*Hartat digjitale: kjo e vitit 1974, dhe harta topografike e NATO-KFOR-it nga marrëveshja 1999, paraqesin të njëjtin territor/kufi të Kosovës ndaj shteteve fqinje.*

ndihmojnë shumë në vëzhgimin e kufirit nëpërmjet rilevimeve aerofotogrametrike, imazheve dhe sistemeve pa pilot (UAV) - dron. Forcat e mbrojtjes dhe të sigurisë kanë në dispozicion këtë teknologji dhe bëjnë vëzhgime e kontrolle me vizualizim nga distanca. Këto dhe arsye të tjera kanë ndikuar për të pasur në tavolinë hartat ushtarake me territorin dhe kufirin e Kosovës. Palët nënshkruese të marrëveshjes, janë pajtuar, ndaj të dhënat janë futur në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë të KFOR-it, e zbatohen edhe nga Policia e Kosovës. Në këtë mënyrë, KFOR-i, dhe policia e Kosovës përveç fizikisht mbajnë në vëzhgim situatën në vijën kufitare të Kosovës me fqinjët
nëpërmjet vizualizimit në kohë reale.

## Çka aprovoi Këshilli i Sigurimit lidhur me territorin e Kosovës?

Patjetër duhet cekur se Këshilli i Sigurimit i KB-së miraton Rezolutën 1244 (1999) me numrin S/RES/1244 (1999) 10 qershor 1999. Kësaj Rezolute i paraprinë përgatitja dhe aprovimi i dokumentit për planin e paqes nga grupi G-8.

Këshilli i Sigurimit (KS) në Rezolutë 1244 (1999), ndër të tjera, përcaktoi katër
çështje të rëndësishme:

- tërheqjen e trupave serbe nga Kosova.
- statusin politik të Kosovë si protektorat të OKB-së,
- përgjegjësinë për administratën civile e merr OKB, dhe
- sigurinë për territorin e Kosovës e bënë KFOR (NATO).

Në piken 9 shkruan "KS, Vendosë përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare të sigurisë që do të vendoset dhe do të veprojë në Kosovë të përfshijnë": dhe vazhdon në paragrafin g. "Kryerjen e detyrave vëzhguese në kufi siç kërkohet". Rrjedhimisht, këtu qartësohet territori i Krahinës se Kosovës, i cili njëkohësisht ishte i prezantuar në hartat topografike të marrëveshjes. Natyrisht, siguria e territorit dhe vëzhgimi i kufirit siç kërkohet mund të bëhet vetëm kur vija kufitare ekziston, Në këtë rast KS me rezolutë e pranon territorin e Kosovës të përkufizuar dhe të përcaktuar nga harta zyrtare të Krahinës se Kosovës dhe të transferuar në hartat e cekura sipër. Pavarësisht qe në disa vende të rezolutës ceket territori i RFJ, ajo nuk e cenon territorin e Kosovës.

**Nga erdhi territori i Kosovës?** Me të drejtë shtrohet kjo pyetje lidhur me ndarjen territoriale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe përkufizimit të saj me shtetet fqinje: nga e mori KFOR këtë kufi? kush e përcaktoi këtë kufi dhe kush e përcaktoi territorin e Kosovës?




Përgjigja është e thjeshtë dhe e qartë: territori i Kosovës është i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 dhe i paraqitur si vijë administrative në hartë me përpjesë të madhe, të quajtura harta kadastrale. Këto harta janë të përpiluara me matje gjeodezike të sakta në të cilën janë kufijtë e parcelave, kufijtë e zonave kadastrale, kufijtë administrativ të komunave dhe kufiri-vija administrative e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974, gjegjësisht Neni 3 shkruan: "Territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e përbëjnë territoret e komunave të tanishme. Territori i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Kuvendit Krahinor". Shtrirja e territorit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSA Kosovës) shihet në hartën zyrtare të vitit 1974 e cila është edhe tani në zbatim në të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës, prandaj s'ka dilema për këtë çështje.

Kur thuhet pranim ndërkombëtar i territorit të Kosovës nënkuptohen vendimet e rëndësishme në shpërbërjen e RSF Jugosllavisë, edhe pse Kosova nuk ishte pjese e agjendës në Konferencën për Jugosllavi. Vendimet ndërkombëtare për Kosovën pa prezencën e saj, por qe konfirmojnë territorin e saj me kufij janë:

- Mendimet e Komisionit Badinter 1991/93.
- Marrëveshja e 09 qershor 1999,
- Miratimi i planit të paqes për Kosovën nga G-8
- Rezolutës 1244(1999),

Në dokumentet e cekura është i bazuar dhe aprovuar nga udhëheqja politike vendore e ndërkombëtare (përveç Serbisë) edhe "Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Shkurt 2007 në të cilin qarte përshkruhet edhe territori i Kosovës. Të gjitha dokumentet e prezantuara paraprakisht lidhur me territorin dhe kufirin e Kosovës konfirmohen edhe nga Mendimi Këshillëdhënës i datës 22 korrik 2010 nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hague-Holandë.

Të gjitha vendimet ndërkombëtare të aprovuara pa përfaqësues të Kosovës, bazë juridike për territorin e Kosovës kishin Kushtetutën e vitit 1974 të RSFJ dhe Kushtetutën e KSA të Kosovës të vitit 1974 si dhe hartat për territorin e saj po nga ai vit. Gjithashtu vendimet e marra në konferenca vendore e ndërkombëtare edhe me pjesëmarrje të përfaqësueseve të Kosovës, dokumente bazë kanë qene ato të vitit 1974 si u cekë me parë. E gjithë kjo është rrjedh si rezultat sepse: territori i gjashtë Republikave dhe i dy Krahinave në ish RSFJ kanë qene të përkufizuara me vija administrative, të njohur si kufij të brendshëm dhe pas pavarësisë se tyre ato u transformuan në kufi ndërkombëtar.

**Mendimet e Komisionit Badinter** për ish-Jugosllavi nga 20 nëntor 1991 deri më 13 gusht 1993. Këtu në mënyrë indirekte është fjala edhe për Kosovën, sepse ajo i kishte kufijtë e jashtëm të definuar. Nga komisioni Badinter, për shpërbërjen e RSFJ, është qartësuar se përkufizimi i territorit përkatësisht kufiri i njësive të RSFJ është ajo vijë administrative qe ishte gjatë funksionimit të Federatës, nëse ndërmjet shteteve nuk ka ndonjë marrëveshje tjetër paqësore. Në këtë rast edhe Kosova me të gjithë fqinjët e ka saktë të përcaktuar vijën ndarëse administrative përkatësisht kufirin.

- Marrëveshja e 09 qershor 1999 paraqet territorin e Kosovës në hartat topografike në përpjesë 1:50 000 dhe 1:100 000. Tre shembuj ilustrues të hartës topografike me kufi dhe me zone të sigurisë shiko hartat e bashkëngjitura.
- Miratimi i planit të paqes për Kosovën nga G-8. Plani i paqes përmbante pikat kryesore: nënshkrimi i marrëveshjes, largimi i forcave serbe, ndalimi i sulmeve ajrore nga NATO, dhe aprovimi i rezolutës nga KS të KB.
- Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të datës 10 qershor 1999, Kosovën e vendos nën Protektoratin e Misionit të Kombeve të Bashkuara i njohur (UNMIK- United Nation Mission in Kosovo 1), me territorin e saj përkufizuar.
- Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës nga Martti Ahtisaari. 2007. Lexo: Aneksi VIII - Sektori i Sigurisë së Kosovës, neni 3. Kufiri.

Ndërsa, pavarësia e R. të Kosovës është shpallur pikërisht konform dokumenteve ndërkombëtare të cekura sipër dhe të mbështetura në Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974. Kjo shprehet nëpërmjet të Deklaratës se Pavarësisë se Kosovës, e cila mbështetet në territorin e Kosovës nga viti 1974. Lexo piken 1 dhe 8 të Deklaratës se Pavarësisë të Kosovës qe lidhet me Pakon e Ahtisaarit, me marrëveshjen e vitit
1999 dhe me kushtetutën e Kosovës të vitit 1974.

Përcaktimi i kufirit Kosovë Serbi në Bruksel në periudhën e marrëveshjes teknike për Menaxhimin e integruar të kufirit në vitin 2013. Për menaxhimin e përbashkët të gjashtë vendkalimeve kufitare Kosovë-Serbi, pas diskutimeve të gjata, në Bruksel u vendos qe ato pika me koordinatat e tyre të fiksohen fizikisht në terren. Pikat e kufirit ndërmjet të Kosovës dhe Serbisë janë fiksuar në terren nga data 27-31 mars 2013, në prani të dy komisioneve shtetërore: nga komisioni i Kosovës dhe nga komisioni i Serbisë. Në zyre dhe në terren komisionet punuan në prani të tri udhëheqjeve politike nga: Kosova, Serbia si dhe nga BE. Kjo vijë administrative, tani kufi shtetëror u realizua me matje GNSS me saktësi centimetrike. Në fund të procesit, pranimi dhe nënshkrimi i këtij kufiri është bërë nga dy palët politike-shtetërore dhe nga përfaqësuesit e BE-së. Prandaj quhet pranim i kufirit nga Serbia dhe pranim i kufirit në nivel ndërkombëtar ndërmjet të Kosovës dhe Serbisë. Urojmë qe këto data të rikujtohen nga të gjithë shqiptaret, dilema për territorin e Kosovës nuk ka, sepse faktet janë prezentë dhe të arkivuara në arkivat vendore e ndërkombëtare.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (15)

# Adem Jashari është njeriu që hyn dhe del nëpër legjendë



Bedri ISLAMI

Gjithë jetën, për 300 vjet me radhë, fisi i Jasharëve kishte qenë në të këputur të perit të jetës. Gjithë jetën kishte qenë vetëm një trashëgimtar, vetëm baca Shaban do të kishte tre djem. Dhe, ky fakt, tronditës deri në thelbin e tij, do ta përbënte edhe kujdesin e jetës së Ademit.
Shpeshherë, miq e dashamirë, ikshin përpjekur të largonin disa nga djemtë e vajzat e familjes së Jasharëve. Nganjëherë edhe i kishin marrë me vete dhe ishin nisur për rrugë, por në kthesën e parë nipërit e mbesat kishin bërë pas dhe ishin kthyer. Askush nuk mund t'i hiqte prej vatrës së tyre. Askush nuk mund t'i ndante nga njëri-tjetri.
Tregon Rifat Jashari: "Thirra një herë në shtëpi dhe fola me Fitimin, një djalë timin. Më tha se po lazdrohem mor babë. Lazdrohu, lazdrohu, i thashë, se tash vij në shtëpi dhe flasim për lazdrimin tënd". "Eh babush, babush, më tha, kur të vish në shtëpi të ka marrë malli, besa të ka këputë malli e ke me e harrue lazdrimin tim". Ka djalë, që po "lazdrohej", në natën e 6 marsit do të vritet në oborrin e shtëpisë, duke luftuar me mitraloz, por nuk e kishte bërë mendjen të ikte nga shtëpia.
Në netët e njohura të marsit, kur e gjithë shtëpia ishte rrethuar trefish dhe rrethimi vazhdonte të thellohej, e gjithë familja e tij ishte aty. Pak më parë, katër nipër e mbesa ishin nisur tek dajallarët, të tjerët ishin aty. Ata që mund të luftonin kishin marrë armët. Të tjerët kishin pritur se mos burrave të shtëpisë u duhej ndihma e tyre. Nuk e kishin bërë ndër mend të dorëzoheshin, të prangoheshin, të merreshin torturoheshin, të merreshin nëpër këmbë. Kishin bërë mend të vdisnin në se do të duhej.
Dhe kishin ecur deri në fund në rrugën e njohur të qëndresës, duke u bërë pjesë dinjitoze e mitit të Jasharëve.
Nuk do të kishte mundur të donte Kosovën apo Shqipërinë, ashtu si i donte Adem Jashari, në se nuk do të kishte adhuruar familjen e tij dhe në se kjo familja nuk do të kishte qenë pjesë e dinjitetshme e jetës së tij.
Shembulli i katërt:
Në dhjetorin e vitit 1997 Adem Jashari dhe Grupi i Drenicës dërgojnë një letër, letra e fundit e tyre kjo, në strukturat që i takonin. Janë disa faqe, të shkruara nga Hamza dhe e firmosur nga të gjithë të tjerët. Në të gjitha rreshtat nuk është shkruar asnjë fjalë për vete, asnjë fjalë për familjen e tij dhe nuk e kishte pasur kurrë, gjithë jetës së tij, në mend një gjë të tillë. Me një respekt të jashtëzakonshëm shkruan për Abedin Rexhën dhe luftën e tij, tregon se si luftuan shokët, si vepruan për të pasur një qëndresë sa më të fuqishme dhe vetëm në fund, si duket duke e ndjerë se lufta do të ishte shumë më tepër se deri atëherë, bën një kërkesë, tepër të zakonshme, "kemi nevojë për më shumë armatim".
Sa herë që e kam lexuar atë letër, kam menduar për njeriun që i kishte vënë shokët mbi veten e tij, që e kishte të shenjtë miqësinë dhe fjalën e dhënë, që nuk e fillonte kurrë nga vetja, por nga të tjerët.
Është i njohur fakti se Ademi ishte fjalëpakë. Nuk i donte dhe as nuk i duronte fjalët e gjata. Por e donte miqësinë me njerëzit e luftës, me njerëzit e zakonshëm, nuk u thoshte kurrë fjalën e rëndë. Sepse ndonëse nuk fliste gjatë, bile - bile fliste tepër pak, ai e nderonte fjalën.
Në gjithë rrethimin e parë, të 30 dhjetorit 1991, Adem Jashari, si e mban mend i vëllai i tij, Rifati, ka folur veç dy herë. Herën e parë i thoshte të vëllait "Veç mos e lësho frontin aty". Herën e dytë, kur i është afruar kullës, policët serbë kishin qenë duke hyrë në oborr. Menjëherë ka hapur zjarr mbi ta, duke i sharë në atë serbishten që ai e dinte fare pak: "Ku po shkoni he nënën e çetnikëve ua ….." u ka bërtitur atyre dhe për nja 4-5 minuta aty i ka shkuar flakë e verdhë.
Askush nuk e mban mend që Adem Jashari t'i ketë thënë fjalën e rëndë. Zakonisht, si kujtojnë shokët e tij, ai për dikë që nuk e donte thoshte veç "hajt hup aty", si për të dashur ta bënte të paqenë njeriun që nuk e dëshironte, por fjalën e rëndë nuk i a thoshte. Sepse e nderonte fjalën si rrallë kush, edhe pse e fliste në të rrallë.
Adem Jashari është njeriu që hyn dhe del nëpër legjendë, ashtu si njerëzit e zakonshëm hyjnë e dalin nëpër oborrin e shtëpisë së tyre. Mbi të gjitha miti i tij, legjenda dhe e vërteta për të ka një akt kulmor, në tri kohë të ndryshme, që lidhet me tri rrethimet që i janë bërë kullës së tij.

### Çfarë ndodhi në tri rrethimet e kullave të Jasharëve?...

Një ditë para sulmit, aty nga mesdita, Rifat Jashari, gjithnjë me merakun për njerëzit e tij, bisedon në telefon me Hamzën. Pas fjalëve të zakonshme, fjala është për një armatim të rëndë, i cili mjerisht ende nuk kishte arritur në Prekaz. Edhe në qeverinë e atëhershme "të Bukoshit", ku kishin kërkuar 600 mijë marka, për të blerë 1000 automatikë, kishin gjetur një derë të mbyllur.
"Çka i keni hallet"- pyet Rifati
"Veç po pritet momenti"- i përgjigjet Hamza.
"A keni tesha me dalë deri në verë"- e pyet përsëri Rifati, duke nënkuptuar armët.
Tjetri atje larg e kupton dhe i thotë: "Me këto armë që kemi, besoj se do t'ia dalim".
18 orë më vonë, pas kësaj bisede në Prekaz do të nisë lufta…
Është një dëshmi tronditëse, por edhe e jashtëzakonshme. Sepse gjithçka që u zhvillua në ato tri ditë ishte e jashtëzakonshme, ishte epike, ndoshta e papërsëritshme në të gjithë historinë botërore. Nuk njoh një rast tjetër të tillë, kur 57 vetë të një fisi dhe të një idealı, do të jepnin jetën "si me le", nuk njoh ndonjë rast tjetër, kur në tri ditë lufte, 27 vetë të një familje do të flijoheshin.
Kullat e Jasharëve në harkun kohor të shtatë viteve janë rrethuat tri herë nga forcat policore serbe, ushtarake e paraushtarake, që nga çetnikët e zakonshëm dhe deri tek kryeçetniku, krimineli i njohur Arkan. Kjo është e njohur tashmë. Është si të thuash një e vërtetë reale që pa dashur të shkon në mend se, edhe kështjella e Krujës është rrethuar tri herë, që nga jeniçerët e zakonshëm dhe deri tek sulltanët.
Të jetë rastësi? Ndoshta, por në jetën e Jasharëve janë kaq të shumta rastësitë e tilla, sa dashur padashur mendimi të shkon tek brusja e legjendave, formësimi i tyre. Ata u ngjizën me njëra-tjetrën, krejt natyrshëm, saqë shpesh herë mendon se e ke të vështirë të gjesh se ku mbaron miti dhe fillon legjenda, ku është e vërteta dhe mitizimi. Mirëpo, kur qetësisht ndjek gjithë rrjedhën e ngjarjeve, "rastësitë" që nuk janë më si të tilla, e kupton se më shumë se gjithçka ishte një domosdoshmëri, kërkesë për rilindje të kombit.
Rrethimi tri herë i Jasharëve është si në tregimet biblike, dhe po ashtu si në ato tregime, pas tyre vjen ringjallja, ringritja. Dhjetë vite pas është e natyrshme të dihet, ose më saktë të shpallet, se çfarë ndodhi pas secilit rrethim të Jasharëve, çfarë gjëje e re ndodhi në jetën e kombit, shkuan huq ata si mund të kenë shkuar shumë gjëra të tjera, apo u sendërtuan diku.
Shkurt mund të thuhej se rrethimi i parë zgjoi krejt Drenicën, mund të thuhet se rrethimi i dytë i Jasharëve zgjoi Kosovën, ndërsa rrethimi i tretë ishte akti madhor që zgjoi gjithë shqiptarët, kudo që ishin.
Rrethimi i parë bëri të ditur se ishte shpallur qëndresa dhe kjo do të vinte përmes njërit nga zërat më të ndjeshëm të rezistencës, Drenicës; rrethimi i dytë qartësoi se Kosova kishte filluar rilindjen dhe se burrat, që kishin vendosur të mos ia kthenin shpinën pushtuesit, ishin ende në Kosovë, të strukturuar rreth ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; rrethimi i tretë hodhi kambanat e zgjimit për të gjithë shqiptarët si çasti i mbrëmë dhe shansi i fundit që mund të kishim për të qenë komb i lirë në të gjitha përmasat e kombit, ose më saktë, në të gjitha përmasat e mundshme, sa më të mundshme të kombit. (Vijon)



# GRAVURA E RRALLË E VITIT 1578, ME FLAMURIN SHQIPTAR NË TË



Nga: Aurel PLASARI

"Marrja e Krujës nga Mehmeti II" është njëra prej gravurave të punuara nga Jost Amman (1539-1591) që shoqërojnë veprën e Marin Barletit në vëllimin e III-të të përmbledhjes "Kronika të turqve" (Chronicorvm Tvrcicorvm) (1578) nga Philippo Leonicero.

Bën përshtypje se si në qytetin që po digjet dhe ndërsa banorët po masakrohen, në njërën nga kullat e tij dallohet ende tek valëvitet flamuri me shenjesën heraldike të Kastriotëve, shqiponjën e zezë me dy krerë, sado që e skicuar "kalimthi". E zmadhuar shenjesa nuk lë vend për dyshim.

Mbas vdekjes së Skënderbeut, në përfundim të një qëndrese prej më se një viti të garnizonit të Krujës, nën komandën e një venedikasi (një Jacopo da Mosto, simbas Romaninit ose një Piero Vettori, simbas Kronikës së Benedetto Deit), ndaj një rrethimi të egër Kruja dorëzohej më 15 qershor 1478 e shtrënguar urie. Gjatë dorëzimit të qytetit, me gjithë premtimin e pushtuesit për t'i lënë banorët të delnin të lirë së toku me pasuritë e tyre, me urdhër të sulltanit u veprua ndryshe: meshkujt u therën, kurse femrat dhe fëmijët u morën skllevër për t'u përdorur nëpër haremet.

Bënë përjashtim vetëm disapak pasunarë, të cilët e blenë jetën e tyre duke paguar (Romanin, Storia documentata, IV, 379, ASV). Tursun-beu, kronikan i Mehmetit II, ka "argumentuar" kështu këtë "ndëshkim" të mbrojtësve të kryekështjellës së Arbërisë, Akça-Hisarit, nga ana e sulltanit: "Ati i Pushtimeve e kishte marrë dhe nënshtruar mbarë territorin e asaj fortese, si dhe kishte prerë rrugët nëpërmes të cilave i mbërrin asaj nga toka e nga deti nozullimet dhe ndihmat.

Deri aty u detyruan të pafetë e mallkuar sa të hanin padallim qen, mace dhe krimba. Ngase rruga e përshkuar në rastin e ekspeditës kundër fortesës së Shkodrës kalonte pranë, të tmerruar nga mundësia e një sulmi prej ushtrisë osmane, të pafetë pranuan të dorëzoheshin. Por kur ishte e qartë se ata qenë dorëzuar ngaqë nuk kishin ç'të hanin, sulltan Mehmeti u shpreh i mendimit se mëshira nuk do të hynte aspak në punë. Ndaj dhe, si shpërblim për kokëfortësinë e tyre, mbështetur në fjalën që thotë se "fara është shkak për shtim", të pafetë besëpakë vajtën t'i bënin shoqëri shpatës ndëshkimore dhe, për mrekulli të një aso shoqërie, skeletet e trupave të tyre u dyfishuan në numër" (Turgun-Beg, Târih-i ebül'feth, 169).

Për venedikasin Navagero komandanti i qytetit së toku me familjen u çuan skllevër në Kostandinopojë (Navagero, Storia, 1153). Ndërsa, simbas gjenovezit Benedetto Dei: "U mor kështjella [e Krujës] më 5 të shtatorit dhe brenda ishte komandant dhe guvernator Piero Vettori, të cilit me urdhër të Turkut të Madh ia prenë të dyja duart…" (La Cronica dall anno 1400 all' anno 1500, 87 verso). Në "Shpalljen për pushtimin e Krujës", lëshuar nga Mehmeti II fill mbas pushtimit të qytetit, ai nuk harronte të njoftonte: "Paskëtaj do të fillojë shkatërrimi i kishave, ndërtimi i medreseve, ndalimi i kambanave dhe prishja e ligjeve. Brenda në zemrat e të pafeve, ku kishte bërë vend pabesia dhe mëkati, paskëtaj do të çelë burbuqja e besimit në një zot të vetëm…" ("Fetih-name-i Akçehisar", nga "Burime osmane", 382). Në qytetin e zbrazur u vendosën kolonë turq, ndërsa vetë qytetit iu ndërrua emri; deri në shek. XIX të krishterët do ta kishin të ndaluar, me ndëshkim vdekjeje, hyrjen natën në qytezë (Jireček, Albanien, 83).


plicationes, votaq; mixta cum miseranda vi lachrymarũ, per aras omnes cadebant, pectoris ac oris (vt mos est gentis) laceratio, fœdiorem aspectum

calamitatis faciebat. Matronarum nihilo segnior dolor, & præter vultus deformationem, dulce videbatur imitari reliquarum mæstitiam. Ni-

E rrallë

## A është kjo e ardhmja e restoranteve? Në Turqi vendosen "kupola" të plastikës

Pandemia e Covid-19 ka bërë që miliarda njerëz në mbarë botën të mbyllen nëpër shtëpitë e tyre për ta luftuar përhapjen e këtij virusi. Megjithatë, me kalimin e muajve dhe numrit të vogël të të infektuarve shtetet në mbarë botën kanë filluar ta aplikojnë lehtësimin e masave mbrojtëse. Për t'u siguruar që klientët do të jenë të sigurt dhe nuk do të kenë nevojë të brengosen se mund të infektohen me Covid-19, një restorant në Turqi ka menduar një ide brilante për këtë. Ata kanë dizajnuar dhe prodhuar disa kupola të plastikës brenda të cilave mund të ulen klientët.



FOTO E DITES



Disa vajza interpretojnë para stadiumit bosh në Tokio. /AP/

E jashtëzakonshme

## Akrobatët që sfidojnë vdekjen në luginën përrallore

Një grup akrobatësh kanë festuar në mënyrën më të mirë të mundshme rihapjen e teleferikut Glacier 3000 në Les Diablerets, Zvicër. Për shkak të lehtësimit të masave për frenimin e përhapjes së koronavirusit, akrobati Freddy Nock u ngjit me biçikletë mbi shufrat e teleferikut me në sfond një luginë përrallore dhe të rrezikshme. Si për t'i bërë edhe më ta vështirë gjërat, ai e bëri këtë me sytë e mbyllur. Edhe perfomues të tjerë dhuruan spektakël, si balerinat mbi shtyllë dhe ecja mbi "rrotën e vdekjes".



## BARSOLETA E DITËS



**- I thirra këta për rrymë, u thashë çka u bo kështu më ka ardhur fatura 75 euro këtë muaj?**
**- Thanë ju kërkojmë falje, kemi bo gabim, se 92 euro të paska ardhur.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

# Xhinse Anti-Covid, "Made in Albania"

COVID-19 nuk ka rimodeluar vetëm psikologjinë e blerjeve te konsumatorët por edhe kërkesat e kompanive për veshjet që ofrojnë në dyqanet e tyre. Krienko Memo, administrator i "Krienko Jeans", që prej vitesh bashkëpunon me marka ndërkombëtare për të prodhuar për llogari të tyre veshje me gamë të gjerë nga xhinset te bluzat e këmishët, shprehet se së fundi i janë kërkuar të aplikojë standarde të reja.
"Ne kemi filluar të prodhojmë xhinse me disa solucione që rezistojnë 50 larje shtëpie me detergjentë të fuqishëm, që kanë të përfshirë edhe pjesën kundër koronavirusit. Janë xhinse që po i prodhojmë këtu, por edhe ato që janë porositur nga jashtë. Kjo është një kërkesë e tyre që të jenë të certifikuara edhe ndaj lagështirës, domethënë që të mos depërtojë dhe të prekë trupin, por të qëndrojë si bulëz mbi veshjen. Kriteri që po flasim është kërkuar për xhinset, bluzat, këmishët. Në përgjithësi për veshjet. Koronavirusi po ndryshon mënyrën sesi ne po prodhojmë" – tregon Memo.





**DASHI**
Disa ndryshime janë në horizont. Puna paraqitet mjaft mirë, ku shumë shpejt gjërat do të përmirësohen dhe mundësitë nuk do të mungojnë.



**DEMI**
Ndikimi i kundërt i Hënës do të krijojë shqetësime në dashuri, sidomos me të lindurit e shenjës së ujorit dhe luanit.



**BINJAKËT**
E mërkura do të jetë mjaft interesante sa i takon dashurisë. Do të jeni të përqendruar tek e ardhmja dhe doni ta lini të shkuarën pas shpine.



**GAFORRJA**
Ju pret një ditë pozitive për dashurinë. Do t'i bëni gjërat me qetësi dhe do të arrini që të bëni një zgjedhje të duhur.



**LUANI**
Përpiquni që të ruani qetësinë dhe të jini të qetë. Ndikimi i Hënës në shenjën tuaj do ta trazojë gjendjen shpirtërore.



**VIRGJËRESHA**
Nuk keni dëshirë për të debatuar apo pasur probleme. Mundësi të reja financiare dhe profesionale paraqiten për të lindurit e kësaj shenje.



**PESHORJA**
Hëna do të ketë ndikim mjaft të favorshëm në shenjën tuaj. Ky është moment rikuperimi në çdo drejtim.



**AKREPI**
Ndikimi i kundërt i Hënës ju fton që të bëni kujdes. Mos u dekurajoni nga problemet në çift.



**SHIGJETARI**
Nëse në muajt e kaluar jeni përballur me një ndarje, tashmë do të keni mundësi të riktheheni në lojë.



**BRICJAPI**
Me ndikimin e kundërt të ujorit dhe akrepit mund të keni probleme. Mundohuni që të pushoni dhe të rrini në qetësi.



**UJORI**
Ndiheni të pasigurt në lidhjen që po jetoni. Duhet të përqendroheni te vetja juaj për ta gjetur qetësinë.



**PESHQIT**
Puna do të jetë në qendër të mendimeve tuaja dhe kjo gjë mund të ketë ndikim negativ në dashuri.

# Will Smith rrëfen mes lotësh: Babai më rrihte, kam ende shenja në trup



Will Smithi ka rrëfyer për jetën personale. Ndër të tjera, ai ka folur për frikën për t'u bërë baba jo sepse nuk donte fëmijë, por sepse fëmijëria e tij ka qenë e mbushur me dhunën e babait. "Jam rritur në një familje ku dhuna ishte pjesë e jetës. Nga ajo dhunë kam plagë të jashtme dhe plagë të brendshme. E shija babanë edhe kur e rrihte nënën time. Këto janë ngjarje që të lëndojnë emocionalisht. Por, përpos të gjithave, unë e kam dashur familjen time. Unë nuk do të kisha qenë kurrë si babai im i dhunshëm. Unë kam qenë një fëmijë i sjellshëm dhe i qetë, pavarësisht çfarë më ndodhte në shtëpi", ka thënë aktori i përlotur.



# Baby G publikon pamje nga prapaskenat e klipit të ri

Baby G pritet që së shpejti ta publikojë projektin e ri muzikor të cilin do ta sjellë bashkë me videoklip. Këngëtarja këto ditë ka ndarë me ndjekësit disa imazhe në rrjete sociale përmes të cilave tregon se si do të duket në videoklip. Artistja në një prej skenave do të shfaqet e veshur tërësisht në të zeza, me pantallona të zi dhe reçipeta me po të njëjtën ngjyrë. Fansave u mbetet të presin e të shohin se çfarë do të sjell këtë herë kjo këngëtare.

# Dy modelet më të kërkuara në botë "çmendin" pushuesit italianë nga jahti luksoz



Ato janë dy nga modelet më të kërkuara në botë. Është fjala për Bella Hadid dhe Hailey Bieber, të cilat kanë kthyer gjithë vëmendjen nga vetja këtë të martë. Pas lehtësimit të masave të marra për Covid-19, Bella dhe Hailey kanë udhëtuar drejt Sardenjës, Itali, për disa ditë pushime. Dy bukuroshet udhëtuan për në ishullin Mesdhe me një avion privat. Dy 23-vjeçaret janë fotografuar me bikini teksa shijonin rrezet e diellit në një jaht luksoz. Gjithashtu, Bella është fotografuar edhe me një palë pantallona të shkurtra të kuqe dhe një bluzë të bardhë, ndërsa në fytyrë mbante një maskë të zezë. Nga ana tjetër, Hailey ishte e veshur e gjitha në të zezë, e në një çast mban maskë të bardhë në fytyrë.

# Nicole Scherzingeri takohet për herë të parë me prindërit e partnerit



Thom Evans dhe Nicole Scherzinger po zyrtarizojnë lidhjen e tyre, madje së fundi këngëtarja u njoftua me prindërit e partnerit. Dyshja kanë udhëtuar në Portugali për t'i takuar Sally dhe Brian, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Babait. Këtë gjë e ka konfirmuar edhe përmes një fotografie të cilën e kanë ndarë me ndjekësit në rrjete sociale, ku shfaqet e gjithë familja bashkë. Në atë foto Nicole, Thom dhe prindërit e këtij të fundit pozuan të buzëqeshur, ndërsa në mbishkrimin e fotos janë fjalët "Gëzuar Ditën Ndërkombëtare të Babait"!




Sport




# Feronikeli kërkon maksimumin ndaj Drenicës

Feronikeli kërkon fitore në përballje me skuadrën e Drenicës. Albert Dabiqaj beson në suksesin e radhës nga skuadra e drejtuar nga Afrim Tovërlani. "Mendoj se është një ndeshje mjaft e vështirë. Drenica vjen pas një humbjeje. Ne do të hyjmë në këtë ndeshje për trepikëshin e radhës në mënyrë që ta mbajmë hapin me skuadrat e tjera. Fatmirësisht nuk kemi mungesa për këtë ndeshje dhe besojmë në fitoren e radhës", ka thënë Dabiqaj



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Skuadra e Feronikelit sot (e enjte) do të përballet me Drenicën në kuadër të javës së 26-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Përballja e dy klubeve nga regjioni i Drenicës do të zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas dhe pritet të jetë shumë interesante.

Mesfushori Albert Dabiqaj ka thënë për "Epokën e re" se "Nikli" nuk ka asnjë mungesë për këtë ndeshje të rëndësishme dhe se synon t'i marrë tri pikët e plota. "Mendoj se është një ndeshje mjaft e vështirë. Drenica vjen pas një humbjeje. Ne do të hyjmë në këtë ndeshje për trepikëshin e radhës në mënyrë që të mbajmë hapin me skuadrat e tjera. Fatmirësisht, nuk kemi mungesa për këtë ndeshje dhe besojmë në fitoren e radhës", ka thënë Dabiqaj.

Aktualisht skuadra e drejtuar nga Afrim Tovërlani renditet në pozitën e pestë me 43 pikë, kurse Drenica është e shtata me 34 pikë. Për këtë ndeshje ka folur edhe sulmuesi Alban Shillova i Drenicës. Ai ka thënë se skuadra kuq e zi synon rezultat pozitiv nga kjo ndeshje. "Do të jetë një ndeshje e vështirë duke e parë formën e Feronikelit. Ne kemi pasur formë të mirë dhe shkojmë për rezultat pozitiv dhe, nëse na jepet mundësia, do të luftojmë edhe për fitore", ka thënë Shillova.

Sot (e enjte) zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera mjaft interesante. Në stadiumin "Zahir Pajaziti", Llapi i Tahir Batatinës e pret Prishtinën me synim që ta marrë maksimumin, por edhe kryeqytetasit udhëtojnë për fitore për faktin se duan të mbesin në hap me skuadrat e tjera që po luftojnë për titull në elitë. Tri pikë sot i kërkon edhe Ballkani që luan si mysafir i Ferizajt. Të tri këto ndeshje të Superligës janë paraparë të fillojnë nga ora 16:45.

# Fitore të reja për Dritën dhe Gjilanin

"Epoka e re"

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Liderja e IPKO Superligës, Drita ka vazhduar me formë të mirë edhe në kuadër të javës së 26-të, pasi e mposhti Vushtrrinë me rezultat 0-4. Skuadra nga Gjilani kaloi në epërsi në minutën e parë të ndeshjes me golin e realizuar nga Xhevdet Shabani. Në minutën e 22-të, Betim Haxhimusa realizoi për 0-2. Rezultati mbeti i pandryshuar deri në dhjetë minutat e fundit, kur Drita realizoi edhe dy gola të tjerë nëpërmjet Astrit Fazliut dhe Kastriot Rexhës nga penalltia për rezultatin final 0-4. Drita tash ka grumbulluar 55 pikë, kurse Vushtrria mbetet e parafundit me 16 pikë. Edhe Gjilani ka rrëmbyer tri pikët e plota nga përballja me Dukagjinin e Klinës, pasi shënoi fitore me rezultat 1-3. Fiton Hajdari shkëlqeu në këtë ndeshje me dy gola të shënuara, kurse një tjetër e shtoi Keita Rezak. Për skuadrën që edicionin tjetër do të bëjë gara në Ligën e Parë realizoi Abdu Kamara. Gjilani, pasi kësaj fitore e rrëmbeu pozitën e dytë me 51 pikë. Dukagjini i Klinës mbetet në pozitën e fundit me vetëm 10 pikë. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar në Mitrovicë, Trepça '89 dhe Flamurtari luajtën baras 1-1. Kuqezinjtë e kryeqytetit realizuan të parët në minutën e 34-të, kur Bashkim Shala realizoi për 0-1, derisa vendasit e barazuan rezultatin në minutat shtesë nëpërmjet Muharrem Jasharit. Pas kësaj xhiro, Trepça '89 renditet në vendin e nëntë me 28 pikë, kurse Flamurtari është një pozitë më lartë me 33 pikë.




**IPKO SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Trepça '89 - Flamurtari | 1-1 |
| Dukagjini - Gjilani | 1-3 |
| Vushtrria - Drita | 0-4 |

**Të enjten takohen:**
16:45 Feronikeli - Drenica
16:45 Llapi - Prishtina
16:45 Ferizaj - Ballkani

## Dumoshi inspekton investimet e MKRS-së në Pejë

PEJË, 24 QERSHOR - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vizituar të mërkurën Komunën e Pejës, me ç'rast ka inspektuar investimet kapitale që po bën MKRS-ja në këtë komunë, projekte që janë në zhvillim e sipër, të cilat kapin vlerën financiare mbi 11 milionë euro. Konkretisht bëhet fjalë për investimet e MKRS-së në stadiumin "Shahin Haxhiislami" në qytetin e Pejës, në ndërtimin e palestrës së sporteve në Zahaq dhe në tjetrën në Loxhë.

Ministrja Dumoshi ka vizituar edhe Komunën e Pejës, ku ka zhvilluar takim me kryetarin e kësaj komune, Gazmend Muhaxheri. Gjatë takimit të tyre është diskutuar për bashkëpunimin në shumë projekte në mes të MKRS-së dhe Komunës së Pejës, të cilat janë në interesin e përbashkët.

Ministrja Dumoshi ka deklaruar se MKRS-ja do t'i qëndrojë afër Komunës së Pejës si dhe komunave të tjera të Kosovës në bazë të kapaciteteve buxhetore që ka, duke u munduar t'i plotësojë kërkesat e tyre e nevojat e qytetarëve. "Ne si MKRS kemi investuar në shumë projekte, sidomos në fushën e sportit. Jemi të interesuar ta zhvillojmë edhe turizmin kulturor. Peja i ka të gjitha kushtet për ta zhvilluar këtë lloj turizmi. Në pjesën e trashëgimisë kemi shumë projekte duke u zhvilluar dhe do të jemi afër Komunës së Pejës", ka thënë ministrja Dumoshi.

Ndërsa kryetari Muhaxheri e ka falënderuar ministren Dumoshi për vizitën dhe gatishmërinë për ta ndihmuar Komunën e Pejës. Ai ka thënë se e ka informuar ministren për prioritetet dhe nevojat e qytetarëve të Komunës së Pejës dhe është shprehur se ka marrë zotimin e ministres se me rishikimin e buxhetit përkrahja për qytetarët e Pejës do të jetë edhe më e madhe.

Ministrja Vlora Dumoshi bashkë me kryetarin Gazmend Muhaxheri ka përcjellë për së afërmi punimet që po bëhen në stadiumin e qytetit "Shahin Haxhiislami", ku ministria për këtë stadium ka investuar rreth 9 milionë euro. Ministrja Dumoshi ka paralajmëruar se stadiumi i qytetit të Pejës do t'i plotësojë kushtet e kategorisë së katër të UEFA-së. "Ky stadium do ta ketë kategorinë e katërt, e cila do t'i plotësojë kushtet që në Pejë mund të zhvillohet edhe ndonjë lojë ndërkombëtare. Ky stadium e ka fushën më të madhe në Kosovë", ka thënë Dumoshi.

Në tërësi projekti i rinovimit të stadiumit "Shahin Haxhiislami" në Pejë do të kushtojë 9 milionë euro.

Ministrja Dumoshi, e shoqëruar nga kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, kanë qëndruar edhe në Zahaq dhe Loxhë, në të cilat vende kanë parë punimet në palestrat



sportive, për ndërtimin e të cilave ministria ka planifikuar 1 milion e 500 mijë euro për palestrën në Zahaq, kurse 400 mijë euro për atë në Loxhë. "Banorët e regjionit të Pejës i kanë merituar këto objekte sportive pasi që ka pasur një mungesë të theksuar të hapësirave sportive që sportdashësit t'i kryejnë aktivitetet e tyre të nevojshme. Presim që projektet të përfundojnë dhe mos të ketë zvarritje të punimeve", ka vlerësuar ministrja.

## Çiklizmi rikthehet pas katër muajsh



PRIZREN, 24 QERSHOR - Bazuar në rekomandimet e institucioneve shëndetësore, Federata e Çiklizmit e Kosovës, në bashkëpunim me Klubin e Çiklizmit "Prizreni", të dielën, më 28 qershor, organizojnë garën e parë pas rikthimit nga pauza shkaku i pandemisë. "Më 28 qershor, nga ora 11:00, në shtegun e gjatë 32 km do të kenë mundësi të marrin pjesë të gjitha klubet e FÇK-së (përfshirë klubet e sapoformuara) si dhe qytetarët, entuziastë të çiklizmit. Gara organizohet nga klubi nikoqir 'Prizreni' dhe për qytetarët që duan të marrin pjesë, luten që të kenë helmetat dhe pajisjet e tjera të nevojshme për ta kaluar shtegun prej 32 km", thuhet në njoftim. Me këtë garë edhe zyrtarisht do të shënohet kthimi i garave të çiklizmit në Kosovë pas pauzës së detyrueshme shkaku i rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19.

# Sheqiri: Ndjenjë e papërshkrueshme të luash për Kosovën



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kosova ka shumë basketbollistë të talentuar që luajnë me sukses në ligat evropiane. Një ndër ta është edhe qendra Dion Sheqiri. Ai paraqitet për skuadrën italiane Allianz Pallacenastro Trieste në Serinë A për të rinj U-18. Sheqiri foli për edicionin e fundit në skuadrën italiane. "Edicioni i fundit ka qenë shumë i suksesshëm. Kam marrë pjesë në shumë turne. Një ndër ta edhe Next Gen Cup. Ka qenë një përvojë e paharrueshme. Synimet e mia janë fillimisht që të luaj në Serinë A dhe më pas në Euro League dhe NBA", ka thënë 17-vjeçari për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka folur edhe për emocionet që i dhuron fanella e Kosovës. "Të luash për Kosovën është një ndjenjë e papërshkrueshme. Është ndjenjë e veçantë ta përfaqësosh shtetin në të cilin jam lindur e rritur", shtoi tutje Sheqiri. Basketbollisti me të ardhme të ndritur thekson se është shumë e rëndësishme për lojtarët/et që të stërviten në këtë kohë të pandemisë. "Unë gjatë kohës së pandemisë kam stërvitur fizikisht në kushte shtëpiake dhe, po ashtu, kam stërvitur edhe teknikisht. Është shumë e rëndësishme të jemi në formë, me ushtrime fizike dhe teknike dhe shpresoj që sa më shpejt mund t'i shohë të gjithë basketbollistët/et të rikthehen në salla më të motivuar se më parë", ka përfunduar Dion Sheqiri, i cili ishte i ftuar nga Kosova U20.

# Austria përgatitet për startin e botërorit në Formula 1



ZELTWEG, 24 QERSHOR - Më 5 dhe 12 korrik, në pistën Zeltweg në Austri, do të zhvillohen dy garat e para sezonale të botërorit të Formula 1. Të gjithë janë në mëdyshje se si do të jetë kjo rinisje sezonale e garave të sportit më të bukur të automobilizmit. Organizatori i garave në pistën austriake, Siegfried Schnabl, sqaron detajet, duke thënë se në total do të zhvillohen 10 mijë teste anti-Covid. "Do ta zbatojmë protokollin e vendosur nga FIA, Liberty Media dhe skuadrat. Të gjithë ata që punojnë në pistë do të hyjnë në zonën e tyre vetëm nëse kanë dalë negativë nga testi. Testi duhet të jetë bërë të paktën në katër ditët e fundit. Ne kemi një staf prej 50 personash që do ta testojë personelin e çdo skuadre dhe të gjithë personat e tjerë", ka thënë Schnabl. "Gjatë kësaj periudhe dyjavore çdo person do të kryejë një tampon çdo pesë ditë. Të gjithë do të kenë një kod dhe çdo e dhënë do të hidhet në databazë. Personat do t'i njohim përmes kodit dhe jo me emër. Rezultati i testit do të dalë brenda 16-24 orëve dhe do të paralajmërohen vetëm ata që punojnë në kontakt të ngushtë me ata që do të dalin pozitivë", u shpreh Schnabl.

## SHKURT

### Dy basketbollistë të Phoenixit rezultojnë pozitivë me Covid-19

NBA vijon të marrë goditje nga koronavirusi teksa vijon përgatitjet e rifillimit të kampionatit që është parashikuar në fund të korrikut në Disney World të Floridës. Dy basketbollistë të Phoenix Sunsit, emrat e të cilëve nuk bëhen të ditur, rezultuan pozitivë me Covid-19 gjatë kësaj jave, gjë që bëri skuadrën e Sunsit t'i mbyllë strukturat e saj si masë parandaluese ndaj këtij virusi. Shteti i Arizonës është një prej vendeve me më shumë të prekur nga koronavirusi në ShBA, me mbi 2 000 raste të reja të raportuara gjatë javës së fundit. Disa prej basketbollistëve te Phoenixit morën pjesë në stërvitjet e fundit vullnetare që klubi i organizoi në Arizona Veterans Memorial Coliseum, ndërkohë që nga dita e martë skuadrat e NBA-s morën miratimin për të krijuar grupe me nga katër lojtarë në të njëjtat struktura në të njëjtin kohë, një vendim që duket se ka pasur pasoja te Sunsi. Ndërkaq, sipas gazetarit të ESPN, Adrian Wojnarowski, edhe te një skuadër tjetër e Konferencës së Perëndimit u shënuan katër raste pozitive me koronavirus javën e kaluar. NBA tashmë ka nisur kryerjen e testeve përditë te skuadrat të cilat po përgatiten për të regjistruar një valë rastesh pozitive me Covid-19.

### Arsenali rinovon kontratat me katër futbollistë

Skuadra e Arsenalit ka rinovuar kontratat me katër futbollistë. Mbrojtësi David Luiz do të qëndrojë te skuadra e Mikel Artetas edhe në sezonin e ardhshëm. Ndërkohë klubi londinez ka blerë përfundimisht kartonët e dy futbollistëve që kishte në huazim, mbrojtësit Cedric Soares nga Southamptoni dhe Pablo Mari nga Flamengo, të cilët do të firmosin kontrata afatgjata. Një tjetër lajm i mirë është se Arsenali ka arritur marrëveshjes me Realin e Madridit për zgjatjen e huazimit të Dani Ceballos deri në fund të këtij sezoni.

### Thiago nuk rinovon me Bayernin, shkak Liverpooli

Mesfushori i Bayern Munchenit, Thiago Alcantara, është kundër rinovimit të kontratës me klubin gjerman, pasi dëshira e tij është t'i bashkohet Liverpoolit. "Spox" dhe "Sport Bild" raportojnë se vendimi i Thiagos për të vendosur kundër rinovimit të kontratës me Bayernin vjen pas interesimit të Liverpoolit për transferimin e tij këtë verë. Kontrata e Thiagos përfundon në vitin 2021, por Bayerni mund të jetë i gatshëm ta shesë mesfushorin këtë verë në mënyrë që të mos e humbë atë për asnjë cent verën e ardhshme.

### Tre futbollistë të PSG-së e kanë kaluar koronavirusin

